



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.04.2019

Ref.: 601/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 mars 2019, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht aplikacioni i Kolegjit Iliria (Nr.1485/18H, datë 31.10.2018) për programin e studimit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS.
2. Refuzohet kërkesa e Kolegji Iliria (Nr.1485/18H, datë 31.10.2018) për aprovim të specializimit, Menaxhment Shëndetësor, në kuadër te programit të studimit: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS.
3. Refuzohet kërkesa e Kolegji Iliria (Nr.1485/18H, datë 31.10.2018) për aprovim të specializimit, Ndërkombëtar, dhe Fianciar, në kuadër te programit të studimit: Juridik, LLB, 240 ECTS.

Arsyetimi

Kolegji Iliria ka parashtruar kërkesë (Nr.1485/18H, datë 31.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditim te programeve të studimit si në vijim: Inxhinieri Softverike, MSc, 120 ECTS; Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS; Juridik, LLB, 240 ECTS (me specializime: Përgjithshëm; Civil; Penal; Ndërkombëtar; Administrativ-Kushtetues, dhe Financiar) Juridik Civil, LLM, 60 ECTS; Juridik Penal, LLM, 60 ECTS, Shkenca Kompjuterike – Informatikë e Aplikuuar, BSc, 180 ECTS (me specializime: Informatikë për Biznes, dhe Informatikë e Aplikuuar); Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS (me specializime: Menaxhment dhe Informatikë; Banka, Financa dhe Kontabilitet; Menaxhment Shëndetësor, dhe Biznes Ndërkombëtar), dhe akreditim të programeve, Infermieri, BA, 180 ECTS, dhe Inxhinieri Civile, MSc, 120 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e Kolegjit Dardania. Duke u bazuar në 1.2 të nenit 10 të UA për Akreditim, sipas së cilës, *“Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik*

përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Sipas pikës 5.3.5 të nenit 26 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), “Nëse programi i studimit përmban edhe specializime, atëherë numri i specializimeve duhet të jetë në përputhje me numrin e stafit akademik të rregullt me gradën akademike PhD, në atë program i cili ka kompetencën e duhur për ato specializime”.

Bazuar në nenin e referuar më sipër, KShC ka trajtuar aplikacionet dhe ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin relevant të kualifikimit të stafit akademik për programet e studimit. Këto të dhëna janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019, dhe pas shqyrtimit të dosjes për staf akademik, për secilin program të studimit dhe specializimet në kuadër të këtyre programeve të studimit, KShC mori vendim që të refuzoj aprovimin e aplikacioneve të Kolegjit Iliria, sipas pikës dy (2) dhe tre (3) të dispozitivit të këtij vendimi.

1. Programi i studimit: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS (me specializime: Menaxhment dhe Informatikë; Banka, Financa dhe Kontabilitet; Menaxhment Shëndetësor, dhe Biznes Ndërkombëtar), ka 120 ECTS, me katër specializime, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.5 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Iliria, duhet të ketë të paktën 4 staf akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit të cilët do të mbulonin secili staf nga një specializim.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky institucion për këtë program të studimit, u konstatua që për specializimin Menaxhment Shëndetësor, në kuadër të programit të studimit, Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS, Kolegji Iliria nuk ka staf të fushës nga programi i studimit, përkatësisht nga specializimi Menaxhment Shëndetësor, siç parashihet me nenin 26, pika 5.3.5 e UA për Akreditim. Ky program i përket fushës ekonomisë, dhe bazuar në nenin 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.5 e UA për Akreditim, bartësit e barogramit duhet të jenë *PhD* në marrëdhënie të rregullt nga fusha e programit të studimit. Për specializimin Menaxhment Shëndetësor i cili është pjesë e programit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Kolegji Iliria ka paraparë si bartës të programit Sabri Hoxha *PhD* në lëndët paraklinikein, fushë kjo e mjekësisë e cila nuk ka të bëjë asgjë me fushën e ekonomisë.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, dhe në mungesë të stafit akademik ashtu siç parashihet në nenin 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.5 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim që specializimi, Menaxhment Shëndetësor, në kuadër të programit të studimit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA, 120 ECTS, nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe me këtë rast vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

2. Programi i studimit: Juridik, LLB, 240 ECTS (me specializime: Përgjithshëm; Civil; Penal; Ndërkombëtar; Administrativ-Kushtetues, dhe Financiar) ka 240 ECTS, me gjashtë specializime, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.5 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Iliria, duhet të ketë të paktën gjashtë staf akademik me gradën shkencore *PhD* me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit të cilët do të mbulonin secili staf nga një specializim.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky institucion për këtë program të studimit, u konstatua që për specializimin, Ndërkombëtar, dhe Financiar, në kuadër të programit të studimit: Juridik, LLB, 240 ECTS, Kolegji Iliria nuk ka paraparë asnjë staf, siç parashihet me nenin 26, pika 5.3.5 e UA për Akreditim.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, dhe në mungesë të stafit akademik ashtu siç parashihet në nenin 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.5 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, KSHC erdhi në përfundim që specializimi, Ndërkombëtar, dhe Financiar, në kuadër të programit të studimit: Juridik, LLB, 240 ECTS, nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe me këtë rast vendosi si në pikën tre dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi u dërgohet:

- BPrAL Kolegjit "Iliria";
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

